




AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

MUNDËSI PËR INVESTIME NË KOSOVË



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Kjo broshurë shërben për qëllime informuese dhe nuk paraqet ofertë!

RRETH NESH


AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT është një organ i pavarur publik që kryen funksionet dhe përgjegjësitë e saj me autonomi të plotë, e autorizuar për të administruar Ndërmarrjet Shoqërore (nën mandatin e saj) në mirëbesim dhe për të mirën e pronarëve dhe kreditorëve të tyre, në përputhje me ligjin .

Procesi i privatizimit filloi në vitin 2003 dhe po vazhdon.

Përmes transformimit të ndërmarrjeve shoqërore, AKP-ja po synon zhvillimin ekonomik në Republikën e Kosovës.

Mundësi unike të investimit janë parashikuar të ofrohen për shitje përmes tenderëve **ndërkombëtarë, publikë dhe transparentë!**





Mundësi të mira për investime

Për kompanitë që janë të interesuara për të investuar në lokacion me **kosto të ulët** dhe **qasje të lehtë** në tregjet e BE, Europës qendrore dhe Ballkanit.

PSE KOSOVA?

Një ndër hapësirat më konkurruese në rajon

Me rezervat e shumta minerare që posedon si **popullsinë me moshën më të re** në kontinent, Kosova përbën një mundësi të shkëlqyeshme për investime në **sektorin e minierave, bujqësisë dhe hotelierisë**.

KOMPLEKSI “INEX”

RRETH NDËRMARRJES

Aktiviteti primar i kompleksit turistik Inex Sharr Planina në Brezovicë është sektori i Turizmit dimëror, për qka edhe është krijuar Qendra Turistike në Brezovicë. Ndërmarrja përbëhet nga një kompleks turistik i cili ka tre hotele, dy kafe-restorante, shtigjet e skijimit dhe asetet e tjera që lidhen me operimin e një qendre skijimi. Marrë parasysh vendndodhjen strategjike të kompleksit, kompania ka potencial për të tërhequr turistë të huaj dhe të bëhet një vendpushim malor i rëndësishëm.

- Qendra e skijimit është e pajisur me 10 ski lifta të cilët përshkojnë 12 km të stazave të skijimit me një gjatësi prej përafërsisht 3,000 m.
- Qendra e skijimit shtrihet në lartësinë prej 1,700 deri 2,500 m mbi nivelin detar.

VENDNDODHJA:	Malet e Sharrit, Kosovë
AKTIVITETI/SEKTORI:	Turizëm dhe Hoteleri
TOKA:	Mbi 200 ha
OBJEKTET:	• Hotel “Breza” • Hotel “Narcis” • Hotel “Molika” • Shtëpia e Stojkut • Restaurant Nacional - Log - Kabin “Murzica” • 10 ski lifta



Grand Hotel PRISHTINA

RRETH NDËRMARRJES

Hoteli është operacional që nga viti 1978 dhe ka një pozitë qendrore në zonën biznesore të Prishtinës. Me investimet e duhura, ky hotel ka potencial të ri-kthej reputacionin e hotelit më të mirë në vend. Aktualisht organizon evente biznesore, takime ndërmarrësish, konferenca dhe mbrëmje festive.



VENDNDODHJA:	Zahir Pajaziti, Prishtinë
AKTIVITETI/SEKTORI:	Turizëm dhe Hoteleri
TOKA:	8900 m ²
OBJEKTET:	• sip. e ndërtesës: 32,000 m²

Kapaciteti i hotelit:
gjithsej 526 shtretër
202 dhoma teke
142 dhoma dyshe
9 dhoma treshe
9 apartamente dhe
2 rezidenca

Hapësirat përcjellëse:
restaurante, taverna, kafeteri, snek bar,
klube të natës, salla të konferencës dhe
parkingje.



MINIERA DHE INDUSTRIA E MAGNEZITIT

MIM GOLESHI

RRETH NDËRMARRJES

MIM Goleshi është industri për përpunimin dhe prodhimin e produkteve të ndryshme të magnezit si magnezium (karbonati i magnezit natyral), magnez i kalcinuar-kaustik dhe magnez i qëndrueshëm ndaj zjarrit (i pjekur apo i mbështjellur me kore silico-gëlqerore). Të gjitha objektet e përpunimit të magnezit janë të vendosura në lokacionin e minierës në Magurë. Si rrjedhojë, të gjitha proceset për prodhimin e produkteve të magnezit formojnë një rrjedhë të ngushtë prodhimi që nuk përfshinë shpenzime të mëdha të transportit brenda kompleksit.

- Vetëm 30% të sip. së minierës janë të hulumtuara, andaj nga përllogaritjet e përafërta supozohet se miniera posedon rreth 12 mt rezerva të magnezitit.

VENDNDODHJA:

Magurë, Prishtinë

AKTIVITETI/SEKTORI:

Miniera dhe minerale

**TOKA
DHE OBJEKTET:**

Tokë: afërsisht 267 ha, përfshirë ndërtesat, pajisjet e fabrikës dhe makineria

- Miniera sipërfaqësore dhe nëntokësore

REZERVAT MINERARE:

- 2.4 mt magnezit
- 68 mt dunit
- 10 mt serpentinë



MINIERA


XIM STREZOVCI

RRETH NDËRMARRJES

Një nga depozitat më të mëdha të magnezitit në rajon me minierë sipërfaqësore dhe nëntokësore. Nxjerrja e xehes në minierën sipërfaqësore ka potencial më të vogël pasi që pjesa më e madhe e rezervave është eksploatuar.

Sidoqoftë, miniera nëntokësore është mbajtur në gjendje relativisht të mirë.

Ndërtesa administrative dhe njësia përpunuese e ndërmarrjes gjenden në qendër të Kamenicës dhe miniera gjendet 14 km në veri të Kamenicës, në fshatin Strezoc.



VENDNODHJA:

Strezovc, Kamenicë

AKTIVITETI/SEKTORI:

Miniera dhe minerale

**TOKA
DHE OBJEKTET:**

- 109 ha sipërfaqe tokësore e minierës
- Gurëthyesi 40 t/h (jashtë funksionit)

REZERVAT MINERARE:

Rreth 1.7 t rezerva të xehes të magnezit të kualitetit të lartë

Rezerva të andezitit dhe zhavorrit



MINIERA

BOKSITET E KOSOVËS

RRETH NDËRMARRJES

Boksitet e Kosovës është e vetmja minierë e boksiteve në Kosovë. Për nga përmbajtja, minerali i boksitit në këtë lokacion konsiderohet si i vetmi i këtij lloji në Ballkan.

Vendndodhja ka ujë që mund të qarkullohet në një sistem të mbyllur. Me investimet e duhura, ndërmarrja ka mundësi që të shëndrohet në një minierë me potencial të përpunimit dhe shitjes së mineralit të boksitit.

Rezervat me shtrirje të gjerë të gurit gëlqerorë dhe argjiles, në të ardhmen e afërt do të jenë shumë të kërkuara marrë parasysh zhvillimet në sektorin e ndërtimtarisë dhe industrisë të rrugëve në Kosovë.

VENDNDODHJA:

Klinë

AKTIVITETI/SEKTORI:

Miniera dhe minerale

**TOKA
DHE OBJEKTET:**

Objekti i drejtorisë
Parku i makinerisë
Fabrika e Llaçit të Thatë
Separacioni i gurit gëlqeror

REZERVAT MINERARE:

- 2.5 mt boksit
- 30 mt gurë gëlqeror
- 100 mt argjilë për çimento



NJËSIA DAMPER

RRETH NDËRMARRJES

Njësia “Damper” kishte filluar të ndërtohej në fund të viteve 70-ta si dhe në fillim të viteve 80-ta, me një infrastrukturë të dedikuar për prodhimin e gomave industriale “Damper”, mirëpo projekti i tillë nuk është finalizuar. Prona si e tillë nuk përfshinë asnjë aset të luajtshëm por ka infrastrukturë të përshtatshme për prodhim industrial.



VENDNDODHJA:

Suharekë

AKTIVITETI/SEKTORI:

Industri

**TOKA
DHE OBJEKTET:**

Ndërtesa të shumta me
konstrukcion çeliku si:

- salla të prodhimit,
- restaurant,
- laborator,
- punëtori mekanike etj.

Sipërfaqja e përgjithshme e
objekteve arrin në 80,417 m².

Toka përfshinë sipërfaqen prej
rreth 31 ha.



NSH LOLA KORPORACIJA

RRETH NDËRMARRJES

NSH Llola Corporation Shtërpce aktivitetin e vet primar e ka pasur në përpunimin e metaleve dhe galanterisë plastike. Ka makina dhe pajisje të cilat janë në gjendje pune. Ka qenë funksionale deri në vitin 2014, para se NSH -ja të përfshihet në proces të likuidimit.



VENDNDODHJA:

Shtërpce

AKTIVITETI/SEKTORI:

Industri për përpunim të metalit

TOKA

Toka përfshinë sipërfaqe prej
1 ha 54 ari dhe 97 m²

OBJEKTET:

Objektet 4,744 m²

- ndërtesa e administratës,
- halla e prodhimit me paisje dhe vegla pune
- kalldatore e demoluar jashtë perdorimit, depo teknologjike
- dhe objekte tjera përcjellëse

Të gjitha objektet janë ndërtim i fortë.



BUJQËSI TOKA DHE VRESHTA

OFERTAT NË TË ARDHMEN

Ofertat do të përfshijnë një numër të tokave bujqësore dhe vreshtave me potencial të madh për zhvillimin e një varg aktiviteteve bujqësore.

Parcela individuale të tokave me sipërfaqe me mbi 50 ha dhe grupe të parcelave me sipërfaqe deri në 200 ha të shtrira në të gjitha rajonet e Kosovës do të jenë pjesë e shitjeve në të ardhmen, duke ju nënshtruar ligjeve relevante.

Toka dhe klima si dhe kompaktsia e parcelave mundësojnë aktivitete bujqësore dhe kultivim të drithërave, pemëve, perimeve, bimëve medicinale dhe produkteve tjera bujqësore.

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

Rr. Agim Ramadani nr. 23, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +381 (0) 38 500 400; Fax: +381 (0) 38 248 076

e-mail: info@pak-ks.org

www.pak-ks.org

